



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:202626
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728398

AC.nr.3576/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. R. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F. K., avokat me seli në rr. “Z. S.” në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” sh.a me seli në Prishtinë, rr.“2 Korriku”, nr.4, me objekt të padisë kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesave të paditësit dhe të paditurës të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1548/16, të datës 15.02.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHEN** si të pathemelta ankesa e paditësit B. R. nga Prishtina dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” sh.a me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1548/16, datë 15.02.2022, në pikën I (një), II (dy) në pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës kontestimore dhe pikën III (tre) VËRTETOHET.
- II. APROVOHET** pjesërisht e themeltë ankesa e paditësit B. R. nga Prishtina, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1548/16, datë 15.02.2022, në pikën II (dy) që ka të bëjë me kamatën ligjore, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” sh.a që paditësit për pjesën e aprovuar të padisë t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8%, për dëmin material do të rrjedhë nga dita e parashtrimit të padisë 13.07.2016, kurse për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë datë 15.02.2022 e deri në pagesën e tërësishme.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1548/16, datë 15.02.2022, ka vendosur: “ I. Aprovohet pjesërisht, e bazuar kërkesëpadia e paditësit: B. R. nga Prishtina dhe, detyrohet e paditura: Kompania e Sigurimeve “E.” sh.a me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit në aksidentin e shkaktuar me datë 09.06.2016 t’ia paguajë shumat si vijon: Në emër të dëmit jo material:

- a. Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....150.00€
- b. Për friken e pësuar, shumën prej.....90.00€
- c. Për shëmtim trupor shumën prej.....60.00€
- i. Në emër të dëmit material:
 - a. Të pësuar në veturë në shumën.....1,000.00€
 - b. Për ushqim të përforcuar shumën.....37.80€
 - c. Për përkujdesje të personit të tretë shumën.....43.20€

II. DETYROHET e paditura, që paditësit t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8% për pjesën e aprovuar të padisë, nga data e marrjes së aktgjykimit 15.02.2022 deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,004.00€, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit. III. Refuzohet e pabazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit që përfshin shumat si në vijim: për dhembjet e përjetuara fizike në shumën 350.00€; për frikën e pësuar në shumën 210.00€; për shëmtim trupor në shumën 140.00€; për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën 200.00€; për ushqim të përforcuar në shumën 62.20€; për përkujdesje të personit të tretë në shumën 56.80€; si dhe për shpenzime materiale në shumën 100.00 € ”.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit të Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Po ashtu ankesë ka parashtruar edhe e paditura, për shkak të shkeljeve të zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që pjesën e gjykuar ta zvogëlojë duke u bazuar në nenin 195, paragrafi 1, pika e) e LPK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit është pjesërisht themeltë.
- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 13.06.2016, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë sipas bazës së auto përgjegjësisë në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të cilin e ka pësuar në aksidentin e ndodhur me datë 09.06.2016 me fajin e të siguruarit te e paditura shumën prej 2,500.00 €, me kamatë prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën

definitive, krejt këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ndërsa pas vlerësimit të tyre ka marr aktgjykimin e atakuar C.nr.1548/16, të datës 15.02.2022, me të cilin pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash ka theksuar se përgjatë procedurës gjyqësore nuk ka rezultuar të jetë kontestues fakti se aksidentit i komunikacionit ka ndodhur me dt:09.06.2016, në atë mënyrë që i njëjti ka ndodhur mes paditësit dhe L. A. i siguruari tek e paditura mirëpo çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet, nëse paditësi ka të drejtë në kompensim për shkak të lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit të dt:09.06.2016, në lartësinë që kërkohet nga paditësi, kurse për këtë në thelb palët kishin pretendime të ndryshme. Për të përcaktuar bazën e kërkesëpadisë, pra përgjegjësinë e të paditurës, gjykata ka bërë nxjerrjes e provës me ekspertizë të komunikacionit dt:07.11.2021, e punuar nga B. L. ekspert i komunikacionit i cili ka konstatuar se deri tek aksidenti ka ardhur me lëshimet primare të paditësit, i cili ka bërë kthim në të majtë pa verifikuar paraprakisht situatën mbrapa mjetit të vet me ndihmën e retrovizorit të jashtëm të majtë, apo me kthim majtas të kokës, me ç'rast do të mund t'a vërente automjetin B i cili në ato momente gjendej në tejkallim të tij në shiritin e majtë të rrugës, kurse lëshime sekondare në këtë aksident ka bërë vozitësi i automjetit B, i cili ka lëvizur me shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar për atë pjesë të rrugës, lëshim ky i cili ka kontribuar në rritjen e lartësisë së pasojave të shkaktuara në këtë aksident.

Gjykata, po ashtu ka administruar si provë mendimin e ekspertit për vlerësimin e dëmit në mjetin motorik, e cila ishte propozuar si provë nga pala paditëse. Eksperti ka paraqitur se, automjeti si pasojë e aksidentit ka pësuar deformime të shkallës së rëndë në pjesët vitale të tij dhe se, riparimi i tij eventual nuk garanton kthimin në gjendjen e mëparshme, i njëjti nuk mund të riaftësohet për pjesëmarrje të sigurt në komunikacion, për këtë arsye konsiderohet "Dëm total Teknik dhe Ekonomik", i cili dëm në kohën e ndodhjes së aksidentit është në lartësinë 3,547.50 €. Ndërsa për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizat mjekësore me ekspert nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë. Eksperti ortoped M. H. në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, si dhe paditësit, ka konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si dëmtime të lehta trupore. Gjykata vendosi të mbajë të paditurën përgjegjëse për kompensimin e dëmit të shkaktuar në 30% të përgjegjësisë, kurse pjesën tjetër të përgjegjësisë prej 70% Gjykata i'a caktoi paditëses. Në këtë drejtim, me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit për bazat e gjykuara Gjykata pati parasysh edhe faktin e përgjegjësisë së ndarë të palëve ndërgjyqëse dhe kontributin e tyre në shkaktimin e aksidentit. Nisur nga kjo rrethanë vendosi t'a ndajë përgjegjësinë ashtu që 70% i takon paditësit dhe 30% të siguarit tek e paditura.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit paditësit, ka mbështetje në dispozitat ligjore të nenit 137, 183. 1 dhe 176 par. 1 të LMD-së e lidhur me nenin 258 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Vendimin lidhur me kamatën e gjykuar, e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, paragrafi 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit të Kosovës i vërtetoi shumat e kompensimit të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë ngase vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës për shkeljet që i referohen zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të së drejtës materiale, përkatësisht neni 183 të LMD-së kur ka theksuar se shumat e kompensimit të dëmit material dhe jo material janë tejet të larta pasi që qëllimi i kompensimit të këtyre llojeve të dëmit nënkupton satisfaksion për të dëmtuarin mirëpo jo mospërputhje të shumave të gjykuara me praktikën gjyqësore. Kjo pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve (të lehta trupore), si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës si edhe përgjegjësinë e shkaktuesit të dëmit, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit material dhe jo material, mbështetur edhe në vlerësimet profesionale të ekspertëve dhe atë ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizës mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit.

Gjatë vendosjes lidhur me kompensimin e dëmit material gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 137 të LMD-së derisa për dëmin jo material, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur në nenin 183 parag.1 të LMD-së, i cili përcakton se “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror“. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse për shkeljet që i referohen shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të

provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Ndërkaq pretendimet ankimore lidhur me faktin se përfaqësuesi i paditësit, ekspertizat e psikiatrisë dhe të ortopedisë i ka pranuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.02.2022 dhe me paraqitjen e fjalës përfundimtare ka kërkuar që të njëjtit ti ofrohet mundësia që të bëjë edhe precizimin e padisë, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat e procedurës kontestimore nga neni 258, par.1 të LPK, në të cilën është paraparë se: *“Paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare”*, ndërsa me par.2 të njëjtit nen është paraparë se: *“Pas përfundimit të seancës përgatitore, e më së voni deri në mbylljen e seancës për shqyrtim kryesor, gjykata mund ta lejoj ndryshimin e padisë vetëm po që se konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit dhe po që se i padituri pajtohet me ndryshimin e padisë”*. Gjukata e shkallës së parë me të drejtë nuk e ka marrë parasysh precizimin e kërkesëpadisë në fjalën përfundimtare të bërë me shkrim nga ana e të autorizuarit të paditësit ngase një gjë e tillë nga interpretimi i dispozitave si më lartë nuk është i lejuar pas mbylljes së shqyrtimit kryesor dhe si i tillë precizimi i parashtruar në fjalën përfundimtare është i palejuar. Në këtë mënyrë gjykata ka përfunduar duke vendosur sipas kërkesave të precizuara me padinë fillestare.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjukata e Apelit të Kosovës e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë edhe për sa i përket konstatimit të gjendjes faktike dhe zbatimit të drejtë të ligjit material. Duke shqyrtuar pretendimet ankimore të palës paditëse lidhur me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike lidhur me pretendimet se me ekspertizën e bërë nuk është bërë ndarja e përgjegjësisë në përqindje, në bazë të kontributit eventual dhe gjykata e shkallës së parë vetëm sipas bindjes së lirë e ka ndarë përgjegjësinë dhe i ka vlerësuar shumat e gjykuara, Gjukata e Apelit vlerëson se janë pretendime ankimore të paqëndrueshme dhe pabazuara, pasi e paditura gjatë procedurës nuk e kishte kontestuar kërkesëpadinë për nga baza dhe e njëjta është e provuar edhe me prova materiale dhe atë nga ekspertiza e komunikacionit e datës 07.11.2021, e punuar nga B. L., ekspert i komunikacionit, është konstatuar se deri tek aksidenti ka ardhur me lëshimet primare të paditësit me veprimet kthim majtas të pasigurt me automjet dhe pengim i automjetit B gjatë tejkalimit. Po ashtu me anë të ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit në mjetin motorik, të punuar me datë 08.11.2021 është konstatuar se dëmi i shkaktuar në automjetin e paditësit është 3.547,00 € ndërsa nga ekspertiza mjekësore e datës 27.12.2021, punuar nga ortopedi M. H. dhe psikiatri M. K., lëndimet janë kategorizuar si lëndime të lehta trupore dhe dëmi jo material është gjykuar në përputhje me këto ekspertiza.

Lidhur me kompensimin e shumës së kompensimit të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë e cila po ashtu është vërtetuar me këtë aktgjykim të gjykatës së shkallës së dytë, kjo gjykatë vlerëson se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë nga personi i tretë (për kohën e cekur në ekspertizë) atëherë vërtetohet se palës së dëmtuar i takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit, në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë.

Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e paditësit dhe të paditurës janë të pathemelta. Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, pasi që e njëjtat është gjykuar në përputhje me nenin 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet procedurale, Gjykata e Apelit e ka vërtetuar vendosjen e shkallës së parë lidhur me to, meqenëse i njëjti vendim, është mbështetur në nenin 452.1 dhe 463 të LPK-së.

Kjo gjykatë vendosi si në pikën e dytë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit për sa i përket kamatës së gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, ngase në këtë pjesë është gjetur se ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale gjegjësisht nenit 382 të LMD-së. Vendimi është ndryshuar sa i përket kamatës së gjykuar dhe është vendosur që lartësia e saj të jetë 8% ashtu që dëmit material llogaritja e saj është caktuar të jetë nga dita e parashtrimit të padisë (sipas kërkesës nga padia), ndërsa për dëmin jo material, rrjedha e kamatës është caktuar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1, pika (d) dhe (e) lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.3576/2022, datë 23.05.2024.

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli